

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke u bazuar në nenin 15 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe me qëllim të implementimit të nenit 16 paragrafit 3 dhe të nenit 14 paragrafit 11 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Bordi i Drejtorëve nxjerr këtë:

**RREGULLORE MBI PROCEDURAT E REKRUTIMIT, NOMINIMIT DHE  
EMËRIMIT TË MENAXHMENTIT DHE DREJTORIT TË SEKRETARISË  
EKZEKUTIVE TË BORDIT TË DREJTORËVE TË  
AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT  
Nr. 01/2016**

**Neni 1**

**Qëllimi i Rregullores**

Agjencia Kosovare e Privatizimit (tani e tutje 'Agjencia') përmes kësaj Rregulloreje ka për qëllim të rregullojë procedurat lidhur me përzgjedhjen, emërimin, kohëzgjatjen, ndërprerjen dhe përfundimin e mandatit të Menaxhmentit të Agjencisë, si dhe zgjedhjen/emërimin, si dhe ndërprerjen e mandatit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë.

**Neni 2**

**Fushëveprimi**

- 2.1. Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për Menaxhmentin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si dhe *mutatis mutandis* dispozitat e kësaj Rregullore do të zbatohen edhe për Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë vetëm në procesin e përzgjedhjes/emërimin dhe ndërprerjes së mandatit. Kohëzgjatja e mandatit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive është përcaktuar me nenin 13.1 të Ligjit për Agjencinë.
- 2.2. Në pajtim me përkufizimet e Ligjit për Agjencinë, Menaxhmenti nënkupton Drejtorin Menaxhues dhe dy Zëvendësdrejtorët Menaxhues të Agjencisë, individualisht dhe kolektivisht.
- 2.3. Në pajtim me Ligjin për Agjencinë neni 14.1 përcaktohet se Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit ka detyrat e përcaktuara në akte nënligjore.

### **Neni 3**

#### **Struktura Organizative e Agjencisë dhe Përrjashtimet**

- 3.1. Në kuadër të strukturës së saj organizative, Agjencia ka Bordin e Drejtorëve, Menaxhmentin e Agjencisë dhe Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit si dhe personelin profesional dhe teknik.
- 3.2. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë janë të përcaktuara me Ligjin për Agjencinë dhe akteve të tjera juridike.
- 3.3. Dispozitat e kësaj Rregullore nuk do të zbatohen për stafin profesional dhe teknik të Agjencisë.

### **Neni 4**

#### **Kompetencat e Bordit lidhur me mandatin e Menaxhmentit dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive**

- 4.1. Menaxhmenti i Agjencisë do të emërohet nga Bordi. Kryetari do të jetë përgjegjës për nominimin e kandidatëve për këto pozita, në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në rregullat e miratuara nga Bordi dhe të lëshuara nga Agjencia. Menaxhmenti i Agjencisë mund në çdo kohë të shkarkohet nga Bordi. Bordi do të përcaktojë kompensimin dhe kushtet tjera të shërbimeve të Menaxhmentit të Agjencisë, pa paragjykuar Nenin 16 paragrafin 5 të Ligjit. Në pajtim me Nenin 15.2.3, këto vendime duhet të merren me shumicën e kualifikuar të votave të Bordit.
- 4.2 Në pajtim me Ligjin për Agjencinë (neni 12 paragrafi 7 ashtu siç është ndryshuar), për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e termave të referencës të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive vendos Bordi i Drejtorëve. Këto vendime kërkojnë shumicën e kualifikuar të Bordit.

### **Neni 5**

#### **Inicimi i Procesit të Rekrutimit**

- 5.1. Procesi i inicimit dhe realizimit të rekrutimit lidhur me pozitat e Menaxhmentit të Agjencisë dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, bëhet nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë. Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Agjencisë do të asistojë Komisionit Përzgjedhës në këtë proces duke ofruar kushtet e nevojshme dhe këshillat eventuale të nevojshme, për të siguruar që ky proces të jetë në pajtueshmëri me parimet dhe rregullat e përgjithshme të rekrutimit të përcaktuara si më poshtë:
  - 5.1.1 Parimi i ligjshmërisë;
  - 5.1.2 Parimi i mos diskriminimit;
  - 5.1.3 Parimi i përgjegjësisë;
  - 5.1.4 Parimi i pavarësisë dhe pavarësisë profesionale;
  - 5.1.5 Transparenca dhe shmangia nga konflikti i interesit;
- 5.2. Procesi i rekrutimit do të iniciohet nga Bordi i Drejtorëve, respektivisht Kryesuesi i Bordit. Varësisht nga rrethanat dhe specifikat që e karakterizojnë Agjencinë, Bordi do të ketë dy opsione për emërimin e Menaxhmentit të Agjencisë dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, opsionin me emërim të drejtpërdrejtë sipas neneve 5.3 dhe 5.4 të kësaj Rregulloreje apo procedurën e rekrutimit me konkurs publik sipas neneve 5.5 dhe 5.6 të kësaj Rregulloreje.

- 5.3 Në rast se Bordi, e sheh të nevojshme për shkaqe të arsyeshme të përcaktuara nga Bordi me vendim, duke vendosur me shumicë të kualifikuar, mund të emërojë Menaxhmentin e Agjencisë dhe/apo Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive në mënyrë të drejtpërdrejtë pa procedurë të hapur konkurimi.
- 5.4 Me këtë rast, Bordi autorizon Kryesuesin ti nominojë Bordit kandidatët për pozitat respektive e të cilët i plotësojnë kushtet e përshkrimit të vendeve të punës për ato pozita. Këto nominime duhet të bëhen së paku 3 ditë kalendarike para mbledhjes së Bordit, gjatë së cilës kohë Kryesuesi do t'i konsultojë anëtarët tjerë të Bordit në lidhje me nominimin e kandidatëve. Bashkë me nominimet Bordit i dërgohen edhe biografitë e kandidatëve përkatës ku përshkruhen kualifikimet, përvojat dhe aftësitë e kërkuara.
- 5.5 Në rast se Bordi nuk vendos për emërim sipas nenit 5.3 të kësaj Rregulloreje, atëherë emërimi i Menaxhmentit të Agjencisë dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive rekrutimi pastaj do t'i nënshtrohet një procedure të hapur konkurrese përmes një konkursi publik. Ky proces dhe kjo procedurë do të zhvillohet sipas dispozitave prej nenit 6 deri në nenin 11 të kësaj Rregulloreje.
- 5.6 Bordi i Drejtorëve para shpalljes së konkursit publik do të përcaktojë përshkrimin e pozitës, përgjegjësitë dhe detyrat e punës, nivelin e kompensimit, mënyrën e vlerësimit të performancës, si dhe kohëzgjatjen e mandatit të tyre përveç kohëzgjatjes së mandatit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive i cili është i përcaktuar me Ligjin për Agjencinë. Ky nen nuk paragjykon kompetencën e Bordit që të ndryshojë apo amandamentojë përshkrimin e punës, përgjegjësitë dhe detyrave, nivelin e pagesës dhe kohëzgjatjen e mandatit në çdo kohe edhe pas shpalljes së konkursit publik nëse e shesh të nevojshme.

## **Neni 6**

### **Procedurat e Rekrutimit**

- 6.1. Në rast të inicimit të procedurës së hapur konkurrese, njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë, me kërkesë dhe autorizim të Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve do të ndërmarrë të gjitha veprimet për zhvillimin e procedurës për pozitat e Menaxhmentit të Agjencisë si dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit.
- 6.2. Procedurën e Rekrutimit dhe veprimet përcjellëse sipas kësaj procedure, për pozitat e Menaxhmentit të Agjencisë, si dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë e realizon duke aplikuar parimet të cekura në nenin 5 të kësaj Rregullore, si dhe zgjidhjet dhe praktikat më të mira, por pa u kufizuar në to dhe pa cenuar dispozitat e Ligjit për Agjencinë apo të kësaj Rregullore.

**Neni 7**  
**Aplikacionet e Kandidateve**

- 7.1. Kandidatët (qoftë brenda apo edhe jashtë institucionit rekrutues), të cilat/ët, konkurojnë për pozitat e Menaxhmentit të Agjencisë dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve duhet ta plotësojnë aplikacionin në njërën nga gjuhët zyrtare.
- 7.2. Dorëzimi i Aplikacioneve bëhet në afatin e përcaktuar në ditën kur është hapur rekrutimi për këto pozita. Aplikacionet mund të dërgohen përmes postes, ose përmes mjeteve tjera elektronike të komunikimit. Aplikacionet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme nëse data në dërgesën postare dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afateve për dorëzimin e aplikacioneve.
- 7.3. Nëse pas datës së fundit për pranimin e aplikacioneve nuk është arritur një numër i aplikacioneve që përfaqësojnë diversitet nga aspekti etnik apo gjinor afati për pranimin e aplikacioneve mundë zgjatet edhe për 5 (pesë) ditë nëse Kryesuesi e sheh të arsyeshme dhe udhëzon Burimet Njerëzore në mënyrë specifike.

**Neni 8**  
**Komisioni Përzgjedhës**

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për pozitat e Menaxhmentit të Agjencisë si dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit do të realizohet nga një Komision Përzgjedhës i cili do të përbëhet prej 3 (tre) anëtarëve. Ky Komision përzgjedhës do të përbëhet nga Kryesuesi i Bordit (njëkohësisht edhe Kryetar i Komisionit Përzgjedhës dhe 2 (dy) anëtarë tjerë të Bordit.

**Neni 9**  
**Procedura e Përzgjedhjes së kandidatëve**

- 9.1. Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë brenda afatit prej 2 (dy) ditëve pas mbylljes së konkursit, krijon një regjistër të aplikacioneve të pranuar me të dhëna e nevojshme (emri i institucionit, titulli i vendit të punës, numri i referencës, data e shpalljes dhe mbylljes së konkursit, data e pranimit të aplikacioneve dhe informacione tjera relevante). Nëse aplikacioni i ndonjë kandidati refuzohet për shkak të mangësive të konsiderueshme, emri i tij do të ruhet në liste ku edhe do ceken arsyet e refuzimit.
- 9.2. Kryesuesi i Komisionit së bashku me anëtarët e tjerë Komisionit Përzgjedhës japin vlerësimet e tyre me shkrim lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve gjatë procesit të rekrutimit.
- 9.3. Kriteret e vlerësimit do të përfshijnë kriteret e vlerësimit si në vijim; 1) arsimimi dhe kualifikimi profesional, 2) përvoja e punës, 3) shkathtësitë dhe aftësitë, 4) elementet e tjera të meritës. Komisioni do të paraqesë një listë prej 3 deri 5 kandidatë me rekomandime të shkruara dhe detajuara.
- 9.4. Komisioni Përzgjedhës përgatit raportin vlerësues dhe formon listën e ngushtë të kandidatëve të cilët do t'i nënshtrohen procesit intervistues. Kandidatët të cilët janë përzgjedhur në listën e ngushtë njoftohen brenda 2 (dy) ditëve prej momentit të përpilimit të listës së ngushtë nga ana e

Menaxherit të Burimeve Njerëzore, ku edhe ftohen të marrin pjesë në intervistë, e cila duhet të mbahet brenda 5 (pesë) ditë pune, nga dita e njoftimit të kandidatëve për përfshirjen në listën e ngushtë.

#### **Neni 10 Intervistimi i Kandidatëve**

- 10.1. Komisioni Përzgjedhës gjatë procesit të intervistimit do të vlerësojë aftësitë e secilit kandidat, duke përfshirë aftësitë udhëheqëse dhe komunikuese, të kuptuarit të rolit dhe misionit të Agjencisë dhe pozitës për të cilën rekrutohet, vizionin e saj/tij për Agjencinë dhe pozitën për të cilën kandidon, aftësitë strategjike, aftësitë për të dhënë rezultate konkrete, aftësitë për të punuar mirë me Bordin, etj.
- 10.2. Brenda afatit prej 3 (tri) ditë pune pas përfundimit të procesit intervistues të kandidatëve, Komisioni do të konsultohet me mes veti dhe do të vendosin me shumicë votash për më së shumti dy kandidatë finalistë. Kryesuesi do të nominojë kandidatin/kandidatët për pozitën e hapur dhe do të ftojë Bordin që në takimin e radhës të vendosë. Bordi do të vendosë mundësisht me konsensus apo me shumicë të kualifikuar të votave dhe do të emërojë kandidatin e zgjedhur.

#### **Neni 11 Njoftimet e Kandidatëve**

- 11.1. Kandidatët e ftuar për intervistë do të informohen me shkrim për rezultatin e intervistimit nga Njësia e Burimeve Njerëzore brenda 5 (pesë) dite pune.
- 11.2. Kandidati i cili merr besimin e Bordit të Drejtorëve për emërim sipas procedurave të parapara me Ligjin për Agjencinë, do të njoftohet me vendimin e Bordit nga Njësia e Burimeve Njerëzore brenda afatit prej 5 (pesë) ditë pune dhe do t'i lëshohet vendimi (akti) i emërimit.

#### **Neni 12 Zgjatja e Mandatit**

- 12.1. Bordi i Drejtorëve, pas kërkesës së Kryesuesit do të vendosë nëse do të zgjatë mandatin e Menaxhmentit të Agjencisë ose të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, apo do të vazhdojë me rekrutim përmes procedurave të parapara në këtë Rregullore .
- 12.2. Nëse Bordi i Drejtorëve vendos që t'i vazhdojë mandatin e Menaxhmentit të Agjencisë ose Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, kohëzgjatja e mandatit do të specifikohet në vendimin e Bordit për Menaxhmentin e Agjencisë. Kohëzgjatja e mandatit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive duhet të jetë në pajtim me Nenin 13, paragrafin 1 të Ligjit të AKP-së.
- 12.3. Kriteret e votimit për zgjatjen e mandateve duhet të jenë të njëjtat sikurse ato për emërim dhe shkarkim të Menaxhmentit të Agjencisë dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive.

#### **Neni 13**

## Aktet e Emërimit dhe Mandati

- 13.1. Nënshkrimi i Aktit të Emërimit për pozitat e Menaxhmentit të Agjencisë dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve, bëhet nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë (në mungesë të tij, nga Zëvendës Kryesuesi i Bordit).
- 13.2. Aktet e emërimit substancialisht do të reflektojnë kushtet e përgjithshme të emërimit siç janë të përcaktuara në shpalljen publike, si dhe kushtet e veçanta të përcaktuara në përshkrimin e vendit të punës dhe të drejtat dhe detyrimet e veçanta që Bordi mund t'i ngarkojë apo përcaktojë për pozitat e caktuara në këto kategori pa cenuar dispozitat e nenit 12.3, nenit 13.1 si dhe nenit 16.3 të Ligjit për Agjencinë. Bordi duhet të këtë mundësinë të shmanget nga/ose ndryshojë termat e referencës të publikuar në fillim nëse kërkohet nga rezultatet e procesit të rekrutimit ose ndryshimit të rrethanave. Arsyetimi për ndryshimin e kushteve të përgjithshme të publikuara duhet të dokumentohet me përpikëri.

### Neni 14

#### Ankesat kundër Vendimeve


- 14.1 Ankesat eventuale të kandidatëve të cilët kanë qenë të përfshirë në procedurën e rekrutimit, mund të paraqiten sipas nenit 23.3 të Ligjit për Agjencinë, ku të gjitha kërkesat për shqyrtimin ligjor të masave të zbatimit të marra, të pranuar ose kundërshtuara nga Bordi do të paraqiten drejtpërdrejt para Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës.

### Neni 15

#### Hyrja në Fuqi

- 15.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi me datën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë dhe në të njëjtën kohë shfuqizon Rregulloren Nr.01/2013 mbi procedurat e rekrutimit, nominimit dhe emërimit të Menaxhmentit dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Prishtinë 02 Shkurt 2016

  
Petrit Gashi  
Kryesues i Bordit të Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit

